

STUDIM GJEOLGJIK
 “NDËRTIMI I TREGUT PËR SHITJET ME SHUMICË DHE PAKICË TË PRODUKTEVE
 USHQIMORE (TIRANA AGRIKULTURË) – Faza III-të
 FARKE, TIRANE.

STUDIM GJEOLGJIK PËR

**“NDËRTIMI I TREGUT PËR SHITJET ME SHUMICË DHE PAKICË TË PRODUKTEVE USHQIMORE
 (TIRANA AGRIKULTURË) – Faza III-të
 Farke, Tirane.**



PROJEKTUES	INXHINIER PROJEKTUES	POROSITËS	Rev
INSTITUTI “DEKLIADA – ALB” sh.p.k Studim,Projektim,VleresimTrajnim, Konsulence Adresa: rr. Milto TUTULANI, perballe f. Juridik. Tirane Tel. Fax: 00355/ 69 78 555 E-mail: dekliadaalb.shpk@gmail.com	InxhGjeolog .Agim HASALAMI InxhGjeoMjedis. Bledar HASALAMAJ	" BASHKIA TIRANË "	00
		Nr. fq/Formati 43/A4 8/A3	Date 2023

Tabela Permbledhese:

- Kushtet gjeologo – inxhinerike të territorit.
- Vecorite morfologjike dhe morfogjenetike.
- Ndërtimi gjeologjik i zones.
- Te dhenat hidrogjeologjike.
- Mbi gjeologjine e formacioneve te zonës objektit.
- Analizat laboratorike e formacioneve gjeologjike.
- Harta gjeologjike e zones shoqeruar me profile.
- Harta hidrogjeologjike e zones shoqeruar me profile.
- Perfundime dhe rekomandime

Kushtet gjeologo -inxhinierike te territorit.

Kushtet gjeologo -inxhinierike te territorit ku do te ndertohet tregu ushqimor.

Ne sherbim te “Hartimin e projektit te zbatimit dhe preventivit te punimeve për ndertimin e nje tregu ushqimor”, u krye studimi i kushteve gjeologo-inxhinierike te sheshit te ndertimit.

Qellimi i ketij studimi eshte percaktimi i karakteristikave fiziko-mekanike te dherave dhe shkembinjve qe takohen ne zonen e studiuar.

Te dhenat e marra nga punimet fushore dhe ato laboratorike do ti sherbejne projektuesve per te parashikuar projektin e themeleve dhe pjeseve te tjera te projektit te ketij objekti multifunksional.

Ne kete studim do te jepen rekomandime per menyren e themelimit te ketij objekti.

Per sqarimin e kushteve gjeologo-inxhinierike te ketij sheshi u shfrytezuan te dhenat siperfaqesore-rievlimi gjeologjik punimet e ndryshme te kryera, studimet gjeologo-gjeofizike analizat laboratorike etj.

Sheshi i ndertimit eshte me siperfaqe te percaktuar ne Farke, TIRANE.

Sheshi ka relief te pjerrret dhe ndodhet ne pjesen kodrinore te Tiranës. Sheshi i ndertimit eshte me kushte optimale ndertimi.

Sheshi i ndertimit me siperfaqe zhvillimi te mjaftueshme. Siperfaqe e sheshit te ndertimit eshte e mjaftueshme per ndertimin e objektit me ambjente te pershtatshme funksionimi.

Ky objekt do te urbanizojë me tej zonen, do te ndikojë ne permiresimin e infrastruktures dhe mbi te gjitha qellimi kryesor i ketij objekti eshte permiresimi i kushteve te mbarvajtjes, lehtesise urbane funksionale, i hapsirave publike,

krijimit te rivitalizimit te sistemit polifunksional dhe ne menyre te veçante per te rritur kushtet sociale te punes.

Per realizimin e ketij studimi jane kryer punimet e meposhtme:

a) Jane kryer disa shpime dhe jane shfrytezuar disa shpime me thellesi 15.00 qe jane kryer per objekte te tjera ne teritor.

b) Jane kryer disa prova te tipit SPT sipas metodikes 1586-11 (ISSMFE techn.Committee 1988.International Reference Test Procedure.)

c) Jane kryer analiza granulometrike sipas metodikes ASTM D6913-04(2009)e1 dhe ASTM D 7928-16e1.

d) Jane kryer analiza Atterberg Limits (kufinjte e plasticitetit) sipas ASTM D 4318-10.

e) Jane kryer Odeometric Test sipas ASTM D2435/2435 M-11.

f) Jane kryer Shear Test sipas metodikes ASTM D 3080/D3080-11.

g) Jane kryer prova te shtypjes njeaksiale per formacionet shkembore sipas metodikes se pershkruar nga rekomandimet e ISRM.

h) Eshte bere interpretimi i te dhenave insitu, te dhenave te laboratorit dhe hartimi i raportit perfundimtar.

i) Thellesia e shpimeve 15.00m, eshte projektuar per te studiuar flishet deri ne thellesine e pritshme per te takuar ndonje zone rreshqitese te vjeter, meqenese gjate ndertimit te objektit do te jete e domosdoshme te behen germime, te cilat mund te krijojne shqetesime per qendrushmerine e shpatit.

Qellimi i Studimit

Destinacioni i ketij studimi eshte percaktimi i karakteristikave fiziko-mekanike te dherave dhe shkembinjvef. Te dhenat e marra nga punimet fushore dhe ato laboratorike do ti sherbejne projektuesve per te parashikuar projektin e themeleve te godinave. Ne kete studim do te jepen rekomadime per menyren e

themelimit të këtyre objekteve të rëndësishme, organizimit të dyshemese së katit për dhe për të eliminuar uljet e diferencuara si dhe për mbrojtjen e skarpatave që janë me problematike për këto zone. Rekomandojmë projektuesit e këtij objekti që të tregojnë vëmendje të veçantë për mbrojtjen e skarpatave me masa inxhinierike të llogaritura sipas të dhënave të këtij raporti gjeologjiko-inxhinierik. Në këto shesh ndërtimi nuk janë konstatuar zona me rreshqitje, por me ndërhyrjen për ndërtimin e themeleve të godinave ekziston mundësia për të prishur ekuilibrin e shpatit.

Objektivi i Punimeve

Shkurtimisht raporti shqyrton çështjet e mëposhtme, të cilat do të jenë të mbështetura me punimet gjeologjike sipas programit të miratuar.

1. Janë rishikuar të gjitha punimet e mëparshme gjeologjike të kryera nga autorët dhe nga autorë të tjerë vendas, të cilat janë kryer për qëllime të tjera por kanë vlera njohëse. Janë parë të gjitha studimet e botuara dhe të pa botuara për zonën në fjalë.
2. Janë studiuar punimet gjeologjike të vjetra që janë kryer për zonën në Tiranë, hartat gjeologjike dhe gjeomorfologjike të zonës ku do të ndërtohen objektet e reja.
3. Janë kryer punime të ndryshme sipas programit të hartuar me siper, por të kombinuar dhe me punimet ekzistuese, të cilat janë shumë të rëndësishme për të kuptuar fenomenet gjeologjike që kanë ndodhur në zhvillimin e historikut gjeologjik të kësaj zone.
4. Një rëndësi të veçantë kanë dhe testimet në laborator të kampioneve të marra në terren nga shpimet.
5. Për kryerjen e këtij studimi janë shfrytëzuar punimet e mëparshme të kryera për zonën në fjalë siç janë:

- a) Studimi gjeologo-inxhinierik dhe gjeoteknik i kryer nga ndermarrja Gjeologji-Gjeodezi per rrethin e Tiranes, Tirane 1950-1990.
- b) Studimet gjeologo-inxhinierike dhe gjeoteknike te kryera nga “Labaratore te licensuar” per qytetin e Tiranes dhe per zonen e Farkes.


Vecorite morfologjike dhe morfogjenetike.

Vecorite morfologjike dhe morfogjenetike te zones ku do te ndertohet tregu ushqimor dhe traseja e lidhjes me systemin.

Ne kete kapitull do te shtjellojme pershkrimin e zones ku shtrihen objekti; format e relievit te sotem dhe te hershem, kushtet gjeologjike te formimit te ketij relievi. Do te behet edhe pershkrimi i fenomeneve gjeologjike dhe gjeodinamike te zones.

Vendodhja e Zones ku do te Ndertohet tregu ushqimor dhe Pershkrimi i Relievit Vendi ku do te ndertohen tregu ushqimor eshte ne shpatin lindor te Farkes. Sheshi i ndertimit ndodhet ne shpatin e nje kodre qe ndertohet nga depozitimet Neogjenike. Shpatet e saj jene te veshur me shkurre mesdhetare. Shpati eshte i deformuar. Ai ndertohet nga shkembinj gjysem-shkembore te Neogjenit, te cilet perajrohen lehte nga agjentet atmosferike dhe lageshtia. Mbi keta shkembinj jane te vendosura depozitimet deluvialo-eluviale. Depozitimet Neogjenike kane trashesi 100-250m. Depozitimet deluvialo-eluviale jane te paqendrueshme ne shpat. Ato levizin nga kuotat me te larta ne kuotat me te uleta. Ne sheshin e studiuar nuk eshte takuar ndonje rreshqitje aktive.

STUDIM GJEOLOGJIK
“NDËRTIMI I TREGUT PËR SHITJET ME SHUMICË DHE PAKICË TË PRODUKTEVE
USHQIMORE (TIRANA AGRIKULTURË) – Faza III-të
FARKE, TIRANE.



Pamje satelitore e zones ku do zhvillohet projekti

Vargu sinklinal i fushes se Tiranes (sinklinali Tirane-Fushe Kruje).

Eshte njesia me lindore e kesaj zone dhe morfologjikisht perfaqeson nje fushe perhapje te ulur-sinklinal te perfaqesuara nga depotizime argjilo-ranore te mesinian-plocenit ne thellesi e aluvialo-lagunore-liqenore te kuartenarit drejt siperfaqes. Ne perendim shtrihet vargu antiklinal Yzberisht-Kashar-Preze e perfaqesuar nga depotizime pliocenike (astian-piacensian) – mesinianit.

Ne pjesen juglindore te sinklinalit shfaqet antiklinali Tirane-Kruje, me elemente te plote dhe strukturat e te cilit kane mbihypur drejt perendimit, duke maskuar ne disa sektore pothuajse krejt vargun sinklinal. Ne pjesen veriore, Porto Romano-Kepi i Rodonit ky sinklinal zgjerohet gradualisht dhe thellohet. Marredhenjet e sinklinali me strukturen antiklinale paraqiten tektonike, amplitude e te ciles eshte mjaft e madhe. Ne sinklinalin e fush Tiranes-Fushe Kruje depotizimet e Kuartenarit vendosen transgresivisht mbi ato te nenshtrira te Mesinian-Pliocenit me mosperputhje kendore e azimutale. Krahu lindor i

sinklinalit është i maskuar nga mbihypja e strukturave antiklinale, ndërsa krahu perëndimor është i shkeputur tektonikisht. Zona e ulur fushore e Tiranes-Fushe Kruje në teresi përfaqëson zone kenetore-liqenore në të cilën janë kryer ndertime e investime në një sipërfaqe të konsiderueshme. Zona ku do projektohet dhe investohet ndodhet në zone fushore-kudrinore e përfaqësuar nga depotizime të Kuartenarit e ato neogjenike. Depotizimet aluviale të kuartenarit janë formuar si rezultat i gërryerjes së depotizimeve të nënshtirra dhe akumulimit të depozitimeve gjatë kuartenarit të poshtëm, të mesëm e të sipërm. Prurjet nga lumenjtë, perrenjtë në faza të ndryshme kanë karakter të ndryshëm dhe përfaqësohen në prerje,- në pjesën e poshtme nga nderthurja-argjila rera konglomerate dhe në pjesën e sipërme me suargjila e surera.

Rajoni Tirane-Fushe Kruje nga ana tektonike përfshihet në basenin me perëndimor dhe përfaqëson, sinklinalin e Tirane-Fushe Kruje, ngritjen antiklinale Kashar-Preze-Ishëm që pjesërisht vendoset normalisht mbi depotizimet për një cikël sendimentesh si, mollaset e post mollasat etj.

Karakteristike e vargut antiklinal të Yzberisht-Kashar-Preze është prania e një numri të madh *rrudhosjesh* me dimensione të konsiderueshme dhe asimetri të theksuar perëndimore, të cilat reflektohen në nivele më të thella dhe lidhen me formimin e relievit të sotëm, me gropa ose ultësira ndarese midis tyre, në shumicën e rasteve në trajta horstesh ose grabnesh ose vargantiklinali e vargsinklinali të ndara nga hulli sinklinali si ajo e Gjoles, si dhe me thyerje aktive, ajo e krahut lindor të strukturave Preze-Ishëm që behen shkas për lindjen e terrmeteve. Tektonika e vonëshme e ka fillimin në Miocen të mesëm ndërsa neotektonika i takon harkut kohor kryesisht plioceniko-kuaternar.

Vargu antiklinal Yzberisht-Kashar-Preze-Ishëm.

Shtrihet në jug perëndim të rajonit dhe përfaqësohet nga struktura antiklinale në thellesi.

Strukturat antiklinale shtrihen si ne lindje ashtu dhe ne perendim dhe jan formuar gjate Paleogjenit duke dale dhe ne siperfaqe ne fund te mesinianit. Depotizimit e neogenit vendosen me perputhje stragrafike e kendore mbi depotizimet e nenshtrira. Antiklinalet e mesiperme kane shtrirje veriperendim-juglindje. Keto struktura komplikohet me prishje tektonike ne perendim dhe mbihypin ne zonat sinklinale.

Ne rajonin ne studim verehet prania e nje sere prishjeve tektonike te cilat e kane fraktuar se tepermi zonen ne pergjithesi e sidomos strukturat e mesiperme.

Deshmi e aktivitetit tektonik te vonshem dhe neotektonik jane siperfaqet e sheshimit dhe shpatet e vargut kudrinor midis tyre ne blloqe kudrinore me ne lindje.

Levizjet kontraste neoteknike kane shpene ne formimin e shume shkeputjeve te reja plio-kuarternare ne shumicen e rasteve active, te reflektuara edhe ne relief qe ndajne grabenet nga horstet ose blloqet antiklinale nga ato sinklinale.

Levizjet kontraste neoteknike kane shpene ne ngritje te vazhdueshme duke formuar relieve te buta kudrinore ne disa raste mbi 200 m. te nderprera nga lugina te gjera me shpate me renje te bute dhe me taraca lumore te karakterit eroziv ose erozivio-akumulativ te vendosura ne lartesi te ndryshme (Tirane-Fushe Kruje).

Per sa me lart mund te terheqim konkluzione se, tektonika e neoteknika marrin pjese direkt ne proceset eustatike te nivelit te detit, duke krijuar ndryshimin relativ te tij ne zonat mbihypese apo/dhe subsidente per pasoje, kjo ben qe te rezultojne ndryshime ne situaten morfologjike te zones fushore-kudrinore.

Veçori tjetër është patja në dispozicion e një hapsire të lire sedimentuese shume te gjere, sepse segmentet morfologjike (zone aluviale, shelf i jashtem, shpate e baseni) ndodhen ne distance jot e cenguara, ndaj dhe kemi ritme te larta sedimentimi .

Ndertimi Gjeologjik i zones

Ndertimi Gjeologjik i zones ku do te ndertohet tregu ushqimor dhe traseja e lidhjes me systemin.

Tiparet gjeomorfologjike, lloji i depotizimeve, perberja e tyre dhe vetite fiziko-mekanike te tyre, ne rajonin ne studim ne teresi jane percaktuar dhe jane produkt i levizjeve tektonike, neoteknike, i ndryshimeve pleogjeografike ngritjen e uljeve, e sidomos te zbatcave te detit, te prurjeve aluviale, proluviale nga lumenjte Terkuze-Tirane, perrenjte e perroskat, te rreshjeve atmosferike si dhe te ndryshimeve te planit strukturor gjate kuarternarit.

Depotizimet e Neogjenit.

Jane depotizime te perfaqesuara nga shkembijnje ranore, gelqe-ranor, shtresa me nderthurje argjilo-alevrolit-ranore me prani te shtresave te gipseve ne perendim Ishem, e pranine e konglemerateve ne Kepi i Rodonit e ne krahun lindor e perendimor te antiklinalit Kepi i rodonit. Depotizimet e Pliocenit perhapen thuajse ne te gjithe strukturen me vendosje trangresive ne pjesen kulmore e uniforme e sinlinalleve.

Depotizimet e Kuarternarit.

Keto depotizime ndahen ne disa tipe sipas origjines se formimit:

Depotizimet kuarternare te zones ndertojne sinklinalin e Tirane-Fushe Kruje dhe karakterizohen nga elementet perberese te meposhtme:

Suargjila (te perfaqesuar nga depotizime argjilite-surera)

Suargjila e depotizime lagunore-liqenore (suargjila)

Sendimentet e mesiperme jane vendosur mbi formacionet argjilo-ranore te mesinianit-pliocenil. Vetem ne sinklinalet me perendimor kemi kalim normal stratigrafik nga mollasat mio-pliocenike detare ne sendimentet kuatemare te deltes lagunore-detare.

Depotizimet lagunore-liqenore takohen ne zonen litorale te basenit Tirane-Tirane-Fushe Kruje dhe jane te perfaqesuara ndermjet atyre kontinentale dhe detare. Ato takohen prane deltave te lumenjve kryesore lumi Lana, lumi Tirana. Keshtu nga veriu ne Rodon ne jug ne takojme depotizimet lagunore liqenore. Keto depotizime lagunore-liqenore kane karakteristike kryesore mungesenne to e lendeve organike dhe prania e faunes liqenore (te ujrave te embla). Ato perfaqesohen nga nderthurje shtresash surgjilore, e rerash. Kane trashesi qe luhatet nga disa metra deri ne 10-50 m.

Depotizimet detare ne vendin tone kane perhapje pergjate bregdetit Adriatik nga Karpenni deri ne Gjirin e Lalzit-Rodonit. Ato ne siperfaqe prane vijes bregdetare deri ne disa qindra metra ne drejtim te kontinentit, pastaj ato shtrihen poshte depotizimeve lagunore, aluviale e kenetore. Perfaqesohen kryesisht nga rera te madhesive te ndryshme. Me depozitimet detare jane te lidhura dhe shkriferimet detare te plazheve te sotme, pore she ato te mbuluara ne brendesi te kontinentit.

Vlen te theksohet qe ne fillimet e Holocenit te vonshem (rreth 5000 vjet me pare) deti Adriatik-Jone kufijte i kane pasur me te shtrire.

Kjo fushe paraqet interest e madh si per rezervat e medha te ujrave nentokesor te zbuluar ashtu dhe per mekanizmine formimit hidrogjeologjik. Depotizimet

aluviale-deluviale e liqenore janë formuar përgjate sinklinalit të Tiranë-Thumanes dhe në të dy krahët në shpatet stukturave antiklinale Kashar-Preze. Në shumicën e rasteve, zona Tiranë-Fushë Krujë është e mbuluar nga depotizime aluviale, lagunore-liqenore e argjila, toka vegjetale e bimesi duke formuar fusha dhe sendimente të sotëm të prurjeve të lumenjve e përrinjve. Vetëm në shpatet anësore dallohen të shkeputura mbetje të terracave të vjetra. Në gjeomorfologjinë e zonës në këtë pjesë kanë ndikuar edhe prurjet nga përrinjte e shumta. Në grykëderdhjet e lumenjve e këtyre përrinjve në det janë formuar sendimente suargjilore-surera me trashësi të konsiderueshme. Faktoret që karakterizojnë regjimin hidrologjik të kënetës të zonës për dimore janë si rezultat i një bashkëveprimi me fenomenet detare (baticat-zbaticat) me kushte klimatike në veçori fiziko-gjeografike të pellgut ujëmbledshes. Duke vënë në evidence prurjet e lumenjve theksojmë se kjo ka të bëjë jo vetëm me regjimin e ujërave të basenit por edhe në faktin se këta faktorë ndikojnë në sjelljen dhe përqendrimin e depotizimeve në zonën fushore Tiranë-Tiranë. Në rajonin në studim depotizimet aluviale të Pleistocenit përhapen kryesisht në zonën e ulur sinklinalë Tiranë-Thumane dhe karakterizohen nga meandra të shumta të shoqëruara me sendiment rërë-zhavorrë. Këto depotizime në formën e freskoreve aluviale kanë trashësi që arrijnë deri në disa metra dhe që futen në drejtim të detit Adriatik. Depotizimet e Pliocenit dalin në sipërfaqe të kufizuara, në kodrat e Rodonit dhe përfaqësohen nga facia astiane. Depotizimet e facies astiane dalin në sipërfaqe në pjesën veriore të kodrave të strukturës së Rodonit. Ato përfaqësohen nga ranore, argjila me shtresa konglomeratesh.

Te dhena hidrogjeologjike

Lumenjte Terkuze-Tirana e perrenje te shumte zbresin nga kodrat e Yzberisht-Kashar-Preze-Ishem ne te dy krahet. Shumica e perrenjve jane te pa uje ose kane uje vetem ne kohe te reshjeve. Ata krijojne lugina te ngushta, e te future ne thellesi. Depotizimet e Kuarternarit-Astianit ne fushen e Tirane-Tirane-Fushe Kruje formojne basen te ujrave nentokesor me rezerveve te mira. Ujrat nentokesor ndahen ne dy komplekse:

Kompleksi ujembajtes i depotizimeve te facies astiane-piacensiane.

Kompleksi ujembajtes i depotizimeve kuaternare (rerat)

Kompleksi ujembajtes i depotizimeve te facies te facies astiane perfaqesohet nga shtresa konglomerate dhe ranore. Ne pjesen verilindore ne kodrat e Kashar-Preze mbizoteronte pakot argjilore, ne jug ne kodrat e Yzberisht verehet perhapje e shtresave ranore. Konglomeratet jane te cimentuara fort me cemento karbonato-ranorike dhe permbajne hidroksid hekuri ne zonen e Kepit te Rodonit. Trashesia e shtresave konglomeratike eshte e ndryshme nga disa metro deri mbi 10-20 m. Ne jug shtresa ranore, jane takuar ne siperfaqe, ne thellesine 10-20 m dhe argjilizohen ne drejtim te veriut. Trashesia e shtresave ranore eshte 2-4 m, deri 5-6 m dhe thellesia e takimit te tyre eshte e ndryshueshme ne pjesen jugore.

-Kompleksi ujembajtes i depotizimeve te Kuarternarit

Horizonti i ujrave nentokesor te shtrese se rerave.

Ky horizont ujembajtes eshte me i pasuri ne pellgun e fushes se Tiranes dhe perhapet pothuajse ne te gjithe zonen fushore. Horizontet e shtrese reore-

zhavorre mbesh teten, kryesisht mbi shtresat argjilo-ranore ne zonen e ulur dhe ne zona te veçanta mbesh tetet mbi subargjila dhe argjila.

Depotizimet e Holocenit te hershem jane depotizimet laguno-liqenore- dhe jane depotizimet liqenore, here te faceis se ceket e here kontinentale, pra nderthurje te ujrave te embla ne disa zona te colat vazhdijne te depotizohen sendimente edhe sot.

Ne keto fusha takohen dy e me shume shtresa dhe perfaqesohen nga rera-surera te cilat mbulohen nga depotizime subargjilore-argjilore.

Keto horizonte perbejne horizonte akumulative ne disa metra e kane perhapje disa km ne verilindje e jug..


Ato perfaqesohen nga nderthurje aleveritesh, rerash te imta, llum argjilor me material me te trashhe, zhure e zhavorre dhe me rezerva te konsiderueshme uji. Depotizimet liqenore-kenetore kane perhapje te gjere pergjate Ultesires Adriatike dhe ne zonat fushore. Nga me tipiket do te permendim depotizimet kenetore e ato liqenore ne zonen e Kenetave, etj.

Karakteristika e perbashket e ketyre formacioneve eshte prania ne to e torfave dhe nje materiali te bollshem organik si dhe nderthurja e shtresave te argjilave, alevriteve, rerave te zhureve. Vlen te theksohet qe keto depotizime kane trashesi rreth 10 m vendosen mbi depotizimet detare te Holocenit. Ne pergjithesi depotizimet e Holocenit te formuara nga rurjet e fuqishme te perrjenjve e prroskave dhe kane perberje te imet, te perfaqesuara nga rera te imeta, alevrite dhe argjila dhe me pak ngas depotizime te perfaqesuara nga zhure e zhavorre me trashesi 10-20 m. ne antiklinalin e Yzberisht-Kashar-Preze kemi burime e rezerva te vogla uji.

Thellesia e ujrave nentokesore ne bregdet varion ne nivelet ndermjet 1-10 deri ne 40 m.


STUDIM GJEOLGJIK
“NDËRTIMI I TREGUT PËR SHITJET ME SHUMICË DHE PAKICË TË PRODUKTEVE
USHQIMORE (TIRANA AGRIKULTURË) – Faza III-të
FARKE, TIRANE.

b) MATERIALI GRAFIK, HARTAT,



Zona e zhvillimit te projektit.

Harta topografike e zones



Zona e zhvillimit te projektit.

Harta gjeologjike e zones

STUDIM GJEOLGJIK
“NDËRTIMI I TREGUT PËR SHITJET ME SHUMICË DHE PAKICË TË PRODUKTEVE
USHQIMORE (TIRANA AGRIKULTURË) – Faza III-të
FARKE, TIRANE.



Zona e zhvillimit te projektit.

Harta hidrogjeologjike e zones

Mbi gjeologjine e formacioneve te zonës se objektit.

Ne studimin e fenomeneve gjeologjike te kesaj zone jemi bazuar ne studimet ekzistuese dhe ne informacionet e reja qe kemi marre nga studimi aktual. Bazuar ne keto te dhena po bejme pershkrimin e fenomeneve gjeologjike qe jane prezente ne formacionet gjeologjike qe takohen ne kete zone.

Fenomenet me te dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike qe verehen ne kete zone jane:

- 1. Fenomeni i perajrimit**
- 2. Fenomeni e erozionit**
- 3. Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve deluvialo-proluviale**

Keto fenomene po i shpjegojme nje nga nje meposhte:

Fenomeni i perajrimit eshte i dukshem tek formacionet rrenjesore qe perbehen nga argjilite dhe alevrolite. Keta shkembinj jane depozitime te reja dhe me çimentim te dobet argjilor. Ata nen veprimin e agjenteve atmosferike transformohen nga shkembinj te bute ne dhera. Ky fenomen takohet me teper ne pjesen kodrinore te zones pra ne sheshin e studiuar.

Fenomeni e erozionit. Ky fenomen eshte i dukshem ne formacionet e perajruara te formacionit rrenjesor dhe ne mbulesen deluvialo-eluviale. Rrymat e ujit ne momentin e reshjeve masive gerryejne mbulesen deluvialo-eluviale dhe pjesen e perajruar te formacionit rrenjesor. Rekomandojme qe te tregohet vemendje qe sheshi i ndertimit dhe objektet te mbrohen nga gerryerja e rrymave te ujerave

siperfaqesore qe krijohen ne rastet e reshjeve si dhe ujrat teknologjike qe do te krijohen ne momentin e shfrytezimit te objektit qe do te ndertohe.

Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve deluvialo-proluviale. Keto depozitime perbehen nga shtresa suargjilash dhe argjilash me permbajtje lendesh organike dhe copa nga shkembirrenjesor. Depozitimet deluvialo-proluviale jane te vendosura mbi formacionin rrenjesor. Ato jane pak deri ne mesatarisht te konsoliduara. Ato ne pranine e lageshtise mufaten dhe ne kushtet e thatesires çahen. Zona e ndikimit eshte deri ne thellesine -1.50m.

Ne kete kapitull do te trajtojme perberjen gjeologjike te zones duke shfrytezuar punimet ekzistuese dhe punimet e kryera ne terren.

Bazuar ne materialin e grumbulluar po shtjellojme kushtet gjeologjike te ndara ne studimet ekzistuese dhe ne studimet e reja te kryera nga grupi i studimit.

Studimet Ekzistuese

Ne zonen e kodrave te Farkes, ne Tirane jane kryer shume studime rajonale dhe lokale. Keto studime jane kryer per objektet e ndryshme qe kane te bejne me qendrueshmerine e shpateve te kesaj zone si dhe per projektimin e themeleve te godinave te reja shumekateshe qe jane ndertuar ne kete zone .

Kodrat e Farkes bejne pjese ne zonen e Ultesires Perendimore te Shqiperise. Ne kete zone jane prezente depozitimet Neogjenike dhe depozitimet e Kuaternarit, por ne zonen ku do te ndertohe objekti jane prezente depozitimet e meposhtme:

Depozitimet e Kuaternarit (Q₄ dl +pl)

Depozitimet deluvialo-proluviale perfaqesohen nga suargjila te mesme deri te lehta dhe gradualisht kalojne ne surera dhe rera te imeta pluhurore. Jane depozitime pak deri ne mesatarisht te konsoliduara. Takohen ne gjithe zonen ku do te ndertohen tregu ushqimor ne pjesen siperfaqesore dhe ka trashesi 4.50-5.60m. Keto depozitime siç e kemi permendur jane me perberje argjilore shume aktive.

Depozitimet e Neogjenit (N_1^{2t})

Depozitimet e Neogjenit perbehen nga argjilite dhe alevrolite me ngjyre gri, me çimentim te dobet deri mesatar. Pjesa e siperme e ketyre depozitimeve eshte e perajruar. Ne kodrat e Farkes predominojne shtresat e ranoreve me çimentim te dobet deri mesatar.

Kushtet Hidrogjeologjike

Nga studimet e kryera ne zonen e kodrave te Farkes (nga matjet e kryera ne shpimet per disa vite ne punimet e ndryshme qe autore te ndryshem qe kane kryer per kete zone) rezulton se niveli i ujit nentokesor ne dimer dhe ne vere eshte i pothuajse i njejte. Autoret e ketij studimi kane shfrytezuar te gjitha punimet ekzistuese dhe punimet e reja. Jane kryer matje ne disa kohe gjate gjithe periudhes se studimit dhe rezulton se ne pjesen me te madhe te zones niveli i ujit nentokesor eshte afer siperfaqes se tokes (-7.00-6.80m). Por ne kohen me reshje masive ky nivel ngrihet deri afer siperfaqes se tokes.

Ne Vere ky nivel eshte me i thelle nga siperfaqja e tokes natyrore dhe mund te kete vetem pikime te ujrave nentokesore.

Nga analizat e kryera rezulton se jane ujra neutrale. Ato nuk jane agresive ndaj hekurit dhe betonit.

Analizat laboratorike e formacioneve gjeologjike

Per percaktimin e kushteve te detajuara gjeologjike dhe gjeoteknike te zones ku do te ndertohen Tregu ushqimor ne bashkepunim me investitorin eshte hartuar nje program i detajuar.

Qellimi i Punimeve Fushore

Punimet fushore kane per qellim te percaktojne ne terren karakteristikat e formacioneve gjeologjike ne zonen ku do te behet ndertimi i objektevet te reja. Ne fazen e punimeve fushore jane marre dhe kampionet me strukture te prishur dhe te paprishur per tu analizuar ne laborator. Ne kete faze jane identifikuar dhe fenomenet negative fiziko-gjeologjike qe jane prezente ne kete zone.

Inspektimi i Punimeve ne Terren

Te gjitha punimet fushore si rilevimet gjeologjike dhe shpimet jane kryer nen mbikqyrjen e inxhinierëve gjeolog. Inxhinieret kane mbajtur te gjitha shenimet fushore, te cilat jane krahasuar me te dhenat laboratorike. Mbi bazen e te dhenave te korrektuara nga pershkrimi fushor dhe rezultatet laboratorike eshte bere perpilimi i Raportit Gjeologjik.

Planifikimi i Thellessise se Shpimeve si dhe Caktimi i Tyre ne Terren

Para fillimit te punes ne terren eshte bere studimi i draftit te projektit te detajuar mbi bazen e te cilit jane projektuar punimet fushore.

Per te vleresuar kushtet gjeologjike te zones ku do te ndertohen tregu ushqimor ne territorin e paracaktuar per kete faze studimi jane kryer disa shpime me

thellesi 15.00m dhe jane shfrytezuar disa shpime qe jane kryer prane ketij territori.

Shpimet me Rrotulim

Punimet kryesore qe jane kryer ne studimin gjeoteknik te objekteve te reja jane shpimet me rrotullim, te cilat jane kryer sipas rrjetit qe kemi pershkruar me siper.

Pershkrimi i Paisjeve te Perdorura

Shpimet ne zone jane realizuar me nje pajisje shpimi, te cilen do ti pershkruajme si me poshte.

-Autosonde e montuar ne nje kamion “B-52” prodhim Italian e montuar ne Republiken e Italise mbi nje kamion “ASTRA”.

Ne terren jane kryer testime SPT ne borehole sipas programit te hartuar ne bashkepunim me porositesin. Ndryshimet jane te miratuara prej projektuesve dhe porositesit.

Parametrat e Standart Penetration Test S.P.T

Pesha e çekicit te SPT	63.5kg
Pesha e shtangave te shpimit me diameter 65mm	8.0 kg/ml
Lartesia e goditjes se çekicit	76.40cm
Diametri i brendeshem e karotierit te SPT	34.9mm

Para çdo ekzekutimi te testit SPT fundi i pusit është pastruar me kujdes dhe pastaj thellësia e tij është matur. Gjithashtu thellësia e pusit është matur pas testit të kryer. Gjeologu qe eshte ne terren jep një përfundim lidhur me anomalitë e testit SPT në qoftë se është për efekte gjeologjike, ose për shkak se

